

DHURONI ORGAN DHURONI JETË

Çka është
dhurimi i organeve

DHURIMI I ORGANEVE është procedurë e **DHURIMIT** të organeve, indeve ose qelizave nga një person i gjallë apo i vdekur, me qëllim të transplantimit në trupin e personit tjetër për shkak të shërimit. **Donacioni** është në mënyrë vullnetare dhe pa kompensim financiar.

Cilat organe dhe inde transplantohen zakonisht

- **Veshkët**, për të eliminuar nevojën për dializë
- **Pankreasi**, për të eliminuar nevojën për insulinë
- **Mëlqia, mushkëritë, zemra**, ose zorrët e holla, kur trupi nuk është në gjendje të mbijetesës së mëtutjeshme të pacientit
- **Palca**, e cila përdoret për ripërtirjen e qelizave të gjakut gjatë situatave të caktuara dhe pas terapisë antikancerogjene.
- **Lëkura**, për trajtimin e djegieve të rënda dhe dëmeve tjera
- **Valvulat e zembrës apo arteriet**, në kushte të caktuara
- **Eshtrat**
- **Kornea**, kur kjo shtresë mbrojtëse e syrit është i lënduar për shkak të intervenimit katarakt ose trauma